

VENDIM
Nr. 620, datë 22.9.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË
PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE
NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 6, të vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, para paragrafit të fundit shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Presidenti i Republikës ka të drejtë të ketë këshilltarë të jashtëm. Pagesa e tyre mujore përcaktohet nga Presidenti, në masën deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2022, përballohen nga fondet e institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku